

VENDIM
Nr. 25/2022

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË KOMISIONIT
HETIMOR TË KUVENDIT PËR KONTROLLIN E LIGJSHMËRISË SË
VEPRIMEVE TË ORGANEVE PUBLIKE NË PROCEDURAT PËR NDËRTIMIN
DHE ADMINISTRIMIN E IMPIANTEVE TË TRAJTIMIT TË MBETJEVE
URBANE, NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 81/2021**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 77 dhe pikës 1 të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 22 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” dhe pikës 1 të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të organeve publike në procedurat për ndërtimin dhe administrimin e impianteve të trajtimit të mbetjeve urbane sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Përcjelljen e raportit përfundimtar dhe dokumentacionin e administruar Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 10.3.2022